



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 341/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e Sejdi Hoxhës kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës së Votimit 0307E në fshatin Abri komuna e Glllogocit, për shkak të mungesës të votave, në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Sejdi Hoxhës, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës së Votimit 0307E, në fshatin Abri, Komuna e Glllogocit, për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 07.10.2019, nga Sejdi Hoxhës kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër komisionerëve të Qendrës së Votimit 0307E në fshatin Abri komuna e Glllogocit, në të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve me datën 06 tetor ne Qendrën e Votimit 0307E ne shkollën “Shote Galica” ne Glllogoc është dëmtuar nga komisioneret e kësaj qendre te votimit ku me rastin e numërimit te votave u janë numëruar vetëm 28 vota, ndërsa i njëjti thekson se ka konfirmim se ne këtë QV ka përafërsisht 45 vota.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkritazi me parregullsitë në Qendrën e Votimit 0307E, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga

KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës së Sejdi Hoxhes, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 341/2019 më datën 10.10.2019**

**Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi**



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*